

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SINDIKATA E PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE TË SHQIPËRISË (SPUSH)

Rruga "Bilal Konxholli", Pallati "Dr. & Di", Kati I, Njesia Administrative nr. 8, Tiranë

Cel: 069 35 89 216, e-mail: sindikata.spush@gmail.com

Nr. 327 Prot.

Tiranë, më 14.10.2022

K Ë R K E S Ë

Drejtuar: Drejtuesve të Njësive Kryesore të IAL-ve Publike

Të Nderuar Drejtues të Njësive Kryesore të IAL-ve Publike!

Sindikata e Punonjësve të Universiteteve Shqiptare (SPUSH) kërkon bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj, duke qëndruar në krahun e atyre që ju kanë zgjedhur, si dhe për të na mbështetur në këtë kauzë të përbashkët për arsimin e lartë publik në vend dhe për shoqërinë shqiptare në tërësi.

Në respekt të misionit tuaj si drejtues të njësive kryesore dhe të stafeve akademike, ndihmës akademike dhe administrative, të cilët kanë qenë pjesë e tre protestave publike në ambjentet e universiteteve tona, të organizuara nga SPUSH, lutemi të ushtroni të drejtën tuaj për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme, e drejtë e cila iu takon edhe vetë anëtarëve të këtij organizimi akademik. Lutemi që në këtë Asamble të ftohen dhe punonjësit ndihmës akademikë/administrativë, si dhe përfaqësuesit e Qeverive Studentore, edhe pse këta të fundit nuk janë anëtarë të asambleve të përgjithshme.

Dëshirojmë që në fokus të mbledhjeve të këtyre asambleve të jetë çështja e ecurisë/hapave që duhet të ndërmerren në funksion të realizimit të kërkesave të peticionit të datës 30 Gusht 2022, drejtuar Kryeministrit, Ministres së Arsimit dhe Sporteve dhe Rektorëve të Universiteteve Publike të vendit.

PËR SINDIKATËN E PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE TË SHQIPËRISË

Prof. Asoc. Dr. SANDËR KOVAÇI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Sandër Kovaçi", with a horizontal line underneath it.